



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2024

**“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË 2024 - 2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, gjermës “a”, pika 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e “Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendim nr. 371, datë 18.5.2016 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2016 - 2020, dhe Planit të Veprimit të zbatimit të tij”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të përmendura në dokumentin e politikave dhe planin e veprimit për ndjekjen dhe zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**

**EDI RAMA**